

L I G J
Nr. 8515, datë 21. 7. 1999

**PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË ANONIME “ALBANIAN MOBILE
COMMUNICATION” (AMC)**

Në mbështetje të nenit 78 dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Shoqëria anonime “Albanian Mobile Communication (AMC)” i nënshtrohet privatizimit në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 8306, datë 14. 3. 1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”.

Neni 2

Privatizimi i “AMC-së”, sha, do të realizohet përmes transferimit të të gjitha aksioneve të zotëruara nga shteti.

Neni 3

Formula e privatizimit të aksioneve të “AMC-së”, sha, është:

1. Jo më pak se 51 deri 85 për qind e aksioneve të kapitalit u ofrohen investitorëve strategjikë, të cilët janë shoqëri të specializuara në fushën e telekomunikacioneve.

Paketa e aksioneve të parashikuara në paragrafin e mësipërm do të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur ndërkombëtar.

2. Deri në 15 për qind e aksioneve të kapitalit u ofrohet subjekteve të mëposhtëm:

Ish-pronarëve të mëparshëm të truallit, sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 30. 6. 1994 dhe në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Punonjësve të “AMC-së”, sha, me anë të shkëmbimit të aksioneve me bonot e privatizimit të zotëruara prej tyre.

3. Aksionet që mbeten pas procedurës së përshkruar më sipër do të shiten me ofertë publike ose edhe me ankande publike në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Në kuptim të këtij paragrafi nuk do të zbatohen nenet 206 dhe 207 të ligjit nr. 7638, datë 19. 11. 1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 4

Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i “AMC-së”, sha, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit organik të buxhetit.

Neni 5

Kriteret e përcaktimit dhe procedurat e zgjedhjes së investitorëve strategjikë, si dhe

mënyrat e vlerësimit të “AMC-së”, sha, vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për kryerjen e të gjitha procedurave të tenderit ndërkombëtar për investitorët strategjikë, me asistencën e shoqërisë së huaj konsulente.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2431, datë 28.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**